UDHËZIM
Nr. 7, datë 24.3.2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË ARSIMIT DHE SHKENCËS NR. 47, DATË 27.8.2013 "PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË ME KOHË TË PJESSHME DHE EDUKIMIT NË DISTANCË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2013-2014" DHE UDHËZIMIN E MINISTRIT TË ARSIMIT DHE SHKENCËS NR. 20, DATË 12.9.2012 "PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË ME KOHË TË PJESSHME DHE EDUKIMIN NË DISTANCË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2012-2013"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 112 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", tënenit 33 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, pikës 5 të nenit 16 të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 843, datë 27.9.2013 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit",

UDHËZOJ:

1. Germa "a" e pikës 4 të udhëzimit të ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 47, datë 27.8.2013, ndryshon si më poshtë:

"Fotokopje të noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore dhe certifikatës së notave, dëftesë pjekurie të shkollës së mesme (për kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 876, datë 3.11.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", të ndryshuar, origjinali ose fotokopje të saj të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA) ose të ndonjë dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri.".

2. Fjalia në fund të pikës 5 të udhëzimit të ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 47, datë 27.8.2013, hiqet.

3. Në pikën 13 të udhëzimit të ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 47, datë 27.8.2013, shtohet paragrafi si më poshtë:

"Institucionet publike të arsimit të lartë i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), në formë shkresore dhe elektronike (*hardcopy* dhe në CD), brenda datës 4 prill 2014, listën e kandidatëve që kanë filluar studimet në vitin akademik 2013-2014, të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 876, datë 3.11.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", të ndryshuar. AKP-ja, brenda datës 30 prill 2014, u dërgon institucioneve publike të arsimit të lartë listën përkatëse me numrat e matrikullimit të studentëve.".

4.Germa "a" e pikës 4 të udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 20, datë 12.9.2012 ndryshon si më poshtë:

"Fotokopje të noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore dhe certifikatës së notave, dëftesë pjekurie të shkollës së mesme (për kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 876, datë 3.11.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", të ndryshuar, origjinali ose fotokopje të saj të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA) ose të ndonjë dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri.".

5. Fjalia e fundit e pikës 5 të udhëzimit të ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 20, datë 12.9.2012, hiqet.

6. Në pikën 13 të udhëzimit të ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 20, datë 12.9.2012, shtohet paragrafi si më poshtë:

"Institucionet publike të arsimit të lartë i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), në formë shkresore edhe elektronike (*hardcopy* dhe në CD), brenda datës 4 prill 2014, listën e kandidatëve që kanë filluar studimet në vitin akademik 2012-2013, të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 876, datë 3.11.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", të ndryshuar. AKP-ja,

brenda datës 30 prill 2014, u dërgon institucioneve publike të arsimit të lartë listën përkatëse me numrat e matrikullimit të studentëve.”.

7. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Arsimore dhe Planifikimit Strategjik, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla